



NEWSLETTER

Mars 2024

Nr.3

Dhuna me bazë gjinore në televizionet kombëtare në fokus të takimit të parë publik të ASHMA-së



Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 28 mars mbajti takimin e parë publik për vitin 2024, në të cilin drejtori dr. Zoran Trajčevski bëri një pasqyrë të aktiviteteve të realizuara në përputhje me Programin Vjetor të Punës në tre muajt e fundit. Të pranishmit patën rastin të dëgjojnë për aktivitetet lidhur me mbikëqyrjet e kryera mbi radiotransmetuesit, operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik, botuesve të mediave të shkruara, masat e shqiptuara vërejtje publike, aktiviteteve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në takim u prezantuan dhe gjetjet e Hulumtimit për mënyrën e raportimit të dhunës me bazë gjinore në emisionet informative të televizioneve kombëtare në vitin 2023, që për nevojat e Agjencisë u përgatit nga Instituti për Kërkime Sociologjike dhe Politiko-Juridike pranë Universiteti "Shn. Kirili dhe Metodi" në Shkup. Ai përfshin dhjetë ditët e para të muajve janar, shkurt dhe mars 2023. Hulumtimi përfshin dy pjesë, njëra prej të cilave i referohet bashkëngjitjeve që paraqesin incidente/ngjarje konkrete të dhunës me bazë gjinore, ndërsa e dyta, bashkëngjitjeve që prezantojnë situata të caktuara lidhur me këtë fenomen, si të dhëna nga hulumtime, të dhëna statistikore, në lidhje me institucionet përkatëse dhe masat që marrin.

Nga shtojcat e analizuar, u identifikuan 22 që trajtonin ngjarje konkrete që lidhen me dhunën me bazë gjinore. Analiza rezultoi se ato janë më së shumti në formë lajmi apo reportazhi, aktorët dhe burimet e informacionit janë cituar saktësisht dhe zakonisht transmetohen në fund të emisioneve informative. Lidhur me shtojcat që trajtonin dhunën me bazë gjinore si fenomen, u identifikuan 11 shtojca, në të cilët llojet më të zakonshme të dhunës ishin llojet e dhunës ekonomike, femicideve, dhunës familjare dhe psikologjike.

U mbajt punëtori për trajtimin e gjuhës së urrejtjes në media dhe platformat online



Në kuadër të Tvining projektit "Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Shërbimit Publik Radiodifuziv", më 21 mars u mbajt një punëtori "Përballja me gjuhën e urrejtjes në shërbimet mediatike dhe platformat online", destinuar për anëtarët e Rrjetit kundër gjuhës së urrejtjes në media dhe të punësuarve në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Në fjalën hyrëse, drejtori i ASHMA-së, dr. Zoran Trajčevski, theksoi se Agjencia në 6 vitet e fundit nuk ka konstatuar gjuhë të urrejtjes për të cilën është përgjegjës televizioni apo radioja, por kjo nuk do të thotë se gjuha e urrejtjes nuk është prezente. Drejtoresha ekzekutive e Këshillit për etikë në media në Maqedoni dhe koordinatorja e Rrjetit kundër gjuhës së urrejtjes në media, Biljana Georgievska, theksoi se ka rritje të konsiderueshme të denoncimeve dhe vendimeve të marra nga Komisioni për ankesa pranë Këshillit, që i referoheni gjuhës së urrejtjes në hapësirën e internetit, veçanërisht në pjesën e komenteve në rrjetet sociale.

Për iniciativat dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara për trajtimin e gjuhës së urrejtjes në media dhe platformat online dr. Aleksandar Shafer nga Ministria Federale e Drejtësisë e Republikës Federale të Gjermanisë. Kler Mozelage nga i njëjti institucion ndau rregullat e reja që vlejné për hapësirën e internetit dhe për ndikimin e Rregullores për shërbimet digjitale të Bashkimit Evropian (Akti i shërbimeve digjitale) në luftën kundër gjuhës së urrejtjes.

Përvojat mbi qasjen rregulatore, në takim ndau dhe dr. Nils Shylte nga Zyra Federale e Drejtësisë e Republikës Federale të Gjermanisë, i cili iu referua procesit të harmonizimit të rrjeteve sociale dhe platformave të shpërndarjes së videove me rregullativën evropiane për gjuhën e urrejtjes dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë rregullimit të platformave të internetit.



NEWSLETTER

Është mbajtur prezantimi publik i Draft-Rregullores për qasje në shërbimet mediatike



Më 14 mars, në ambientet e Euro Hous në Shkup, u mbajt prezantimi publik i Draft-Rregullores për qasje në shërbimet mediatike, përgatitur në kuadër të projektit “Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave në Maqedoninë e Veriut (PRO-FREKS)”. Në fjalën hyrëse, drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dr. Zoran Trajčevski, theksoi se hartimi i aktit rrjedh nga ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nga korriku i vitit 2023, të cilat mundësojnë akses të detyrueshëm në shërbimet mediatike për personat me aftësi të kufizuara.

Për zbatimin e detyrimeve të rregullativës në korniza evropiane, në këtë aktivitet foli dhe Deirdre KEVIN, konsulente e Këshillit të Evropës me ndihmën e të cilës ASHMA-ja përgatiti tekstin për Draft-Rregulloren, duke prezantuar përvojat dhe praktikatat e vendeve të Unionit Evropian në aspekt të ofrimit të përmbajtjeve të përshtatshme për personat me dëmtim të dëgjimit dhe shikimit nga ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Gjatë prezantimit të Draft-Rregullores, mr. Sasho Bogdanovski, udhëheqës i Sektorit për të drejtat e njeriut dhe edukimit mediatik në ASHMA, ndër të tjera theksoi detyrimet që duhet t'i përbushin radiot, televizionet dhe shërbimet mediatike me kërkesë dhe si nëpërmjet rrugës elektronike të realizohen kontakte me Agjencinë për çështje që kanë të bëjnë me aksesueshmërinë e shërbimeve mediatike. Pas tekstit të Draft- dokumentit, është hapur diskutim publik në të cilin të gjitha palët e interesuara mund të marrin pjesë me mendimet dhe propozimet e tyre dhe t'i dorëzojnë me shkrim në e-mail adresën contact@avmu.mk. Seanca dëgjimore zgjat 90 ditë, deri më 10 qershor 2024.

U miratua udhëzimi për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me qëllim të shpjegimit për mënyrën e zbatimit të rregullave të Kodit Zgjedhor, më 29 mars miratoi Udhëzimin për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024.

Në udhëzim përfshihen rregullat për kufijtë e reklamave politike me pagesë (RPP), përcaktimin e porositesit të reklamës, shpërndarjen e kohës në lajme tek Shërbimi Publik, prezantimin politik falas në kanal in parlamentar, sigurimin e aksesueshmërisë së përmbajtjes për procesin zgjedhor për personat me aftësi të kufizuara, rregullat për raportim në ditët e heshtjes zgjedhore, veçanërisht për periudhën e mbulimit të dy proceseve zgjedhore.

Gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale, në rrethin e parë të votimit, transmetuesit mund të emetojnë gjithsej nëntë minuta e tridhjetë sekonda kohë shtesë për reklamim në kohë reale të programit të transmetuar, ekskluzivisht i destinuar për RPP. Në Udhëzim është përcaktuar saktë shpërndarja e këtyre minutave ndërmjet shtatë bartësve të listave/kandidatëve për kryetar. Në rrethin e dytë të votimit, koha totale për RPP do të varet nga koha e RPP që e shfrytëzojnë bartësit e listave/kandidatët për kryetar që do të vazhdojnë fushatën zgjedhore në rrethin e dytë.

Gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Parlamentare, transmetuesit kanë të drejtë për nëntë minuta e tridhjetë sekonda shtesë për reklamim në kohë reale, ekskluzivisht për RPP. Pas konfirmimit të listave të dorëzuara të kandidatëve për deputetë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Agjencia përkatësisht do të plotësojë Udhëzimin për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024.

Gjatë kohës së heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale, më 23 dhe 24 prill (deri në ora 19) 2024, vazhdon fushata zgjedhore për Zgjedhjet parlamentare, por ndërpritet mbulimi mediatik në lajme dhe në emisionet e veçanta informative të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për dy proceset zgjedhore.

Publikohet raporti për prezantimin mediatik parazgjedhor nga 15 shkurti deri më 7 mars

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, më 15 mars publikoi Raportin e monitorimit të përfaqësimit mediatik për zgjedhjet e ardhshme presidenciale dhe parlamentare, për periudhën nga 15 shkurt deri më 7 mars 2024. Në monitorim janë përfshirë nëntë shërbime programore televizive kombëtare – TVM 1, TVM 2, TV Alsat-M, TV Alfa, TV Channel 5, TV Sitel, TV Telma, TV 21-M dhe TV 24 Vesti.

Në raport analizohen bashkëngjitjet në edicionet qendrore të lajmeve /ditarit TV, lidhur me tema rreth zhvillimeve parazgjedhore dhe rasteve aktuale social-politike vendase, si dhe lloje të tjera emisionesh të kësaj shtrirje tematike. Nga gjetjet e monitorimit u rezultoi se gjatë kësaj periudhe nuk u konstatuan shkelje të disoizitave të Kodit Zgjedhor.



NEWSLETTER

Njoftime publike

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 22 mars, përmes një njoftimi për media, dënoi sulmin fizik të kryer nga ana e Vesna Jakimovska nga Kërçova, ndaj gazetarit Furkan Saliu nga Portaliks. Në njoftim thuhej se duke marrë parasysh se sulmi ndaj gazetarit në Kodin Penal trajtohet si sulm ndaj personi zyrtar, është absolutisht e pa pranueshme një sjellje e tillë nga persona që janë pjesë të sistemit ligjor. Si në disa raste deri më tani, Agjencia ka theksuar se është e nevojshme të ofrohen kushte për kryerjen e sigurt dhe profesionale të detyrave të punës së përfaqësuesve të mediave.

Më 4 mars, përmes një njoftim publik është dënuar fjalimi vulgar dhe i pahijshëm i kryetarit të partisë politike Levica, Dimitar Apasiev në rrjetin social Facebook, i cili i referohej televizionit Kanal 5. Përveç etiketimit publik dhe diskreditimit të mediumit dhe personit të tij përgjegjës, në njoftim është referuar edhe thirrje për bojkot të reklamuesve dhe produkteve të tyre në TV Kanal 5, duke përmendur një antifushatë të organizuar sistematike. Në njoftim vihet në dukje se një sjellje e tillë është absolutisht e papranueshme, sidomos kur bëhet fjalë për politikanë dhe persona publike të cilët duhet të tregojnë nivelin më të lartë të respektimit të profesionit të gazetarit dhe medias.

Debat i hapur publik për Draft-Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim (marketing) të produkteve

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 9-të mbajtur më 12 mars, miratoi Draft-Udhëzimin për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për marketing të produkteve. Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit rezulton nga ndryshimet e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nga korriku 2023, ku janë bërë ndryshime në lidhje me plasimin e produkteve.

Agjencia ftoi të gjithë transmetuesit, ofruesit e ASHMA-së sipas kërkesës dhe palët e interesuara, me mendimet dhe propozimet e tyre, të marrin pjesë në debatin publik dhe të njëjtët me shkrim t'i dorëzojnë në mënyrë elektronike në email-adresë contact@avmu.mk. Debatin publik zgjat 90 ditë dhe përfundon më 11 qershor 2024.

Mbikëqyrje mbi operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi operatorët Biv Piramida, Nafi dhe Beko, Kablecall, Skupi Kable, Vinsat Kabel, Drim Sat IPTV dhe Kable-Net për detyrimin e paketës programore që ata ritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë për të ofruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe detyrimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimin e programeve që ritransmetojnë. Gjatë mbikëqyrjeve nuk janë konstatuar shkelje.

Agjencia ka kryer mbikëqyrjetë të kontrollit programor mbi operatorët Telenet Kom, Multimedia Network L dhe Infel-KTV për të përcaktuar nëse operatorët kanë vepruar sipas masave vërejtje publike që i referohen ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk janë të regjistruara në Agjenci, në pajtim me nenin 141 të LSHMAAV. Nga mbikëqyrja është konstatuar se operatorët plotësisht kanë vepruar në përputhje me dispozitatat ligjore..

Masat e shqiptuara vërejtje publik

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 8-të mbajtur më 1 mars 2024, miratoi vendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për shërbimin e dytë programor televiziv të Radio Televizionit të Maqedonisë TVM 2, për shkak të mostransmetimit së paku 40% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.